



Data: 25.09.19 Ref.: 1779/196

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 77-të, të mbajtur më 16.09.2019 mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohet Akademia Evolucion në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

I. Akademia Evolucion ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Akademinë Evolucion, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional. Vizita është realizuar me 29.07.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Stephen Adam dhe Oana Sarbu.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Akademisë Evolucion dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Akademia Evolucion përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Akademia Evolucion i plotëson substancialisht shtatë (7) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit; Menaxhimi i Cilësisë; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet

mbështetëse; Burimet dhe Hapësirat; Bashkëpunimi Institucional) ndërsa plotëson pjesërisht katër (4) të tjera (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Mësimdhënia dhe Mësimnxënia; Hulumtimi).

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Akademisë Evolucion;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë